

Clean Fast sh.p.k

Pasqyrat Financiare së bashku me raportin e audituesit të
pavarur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

Tiranë, Shqipëri

PERMBAJTJA:

PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE	1
PASQYRA E PERFORMANCES	2
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	3
PASQYRA E LEVIZJEVE NE KAPITAL	4
1. Informacion i pergjithshem	5
2. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile	5
2. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile (vazhdim)	6
2. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile (vazhdim)	8
3. Mjete monetare	10
4. Te drejta te arketueshme	10
5. Inventaret	10
6. Aktivet materiale dhe jo materiale	11
7. Furnitore dhe detyrime te tjera	12
8. Detyrime ndaj paleve te lidhura	12
9. Kapitalet e veta	12
10. Te ardhurat nga shitja e mallrave	12
11. Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	12
12. Shpenzime per personelin	12
13. Shpenzime te tjera	13
14. Shpenzime financiare	13
15. fitimi neto	13
16. Ngjarje te tjera pas dates bilancit	13

SAO ADVISORS SHPK

Rr. Aleksanër Moisiu, Kompleksi Orion,
Godina C
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 662 567 867

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Ortakët e Shoqërisë Tregtare Clean Fast shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare Clean Fast shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël me të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2016, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomali të materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

SAO ADVISORS SHPK

SAO ADVISORS SHPK

Rr. Aleksander Moisiu,
Kompleksi Orion, Godina C
Tiranë Shqipëri

25/07/2017

Aldo Spahiu



PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE
(Gjithë vlerat në Lekë)

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
AKTIVI			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	3	49,693	-
Të drejta të arkëtueshme	4	7,392,670	-
Inventarët	5	230,440	-
Shpenzime të shtyra			
Totali i aktiveve afatshkurtra		7,672,803	-
Aktivët afatgjatë			
Aktive materiale	6	2,428,167	-
Aktivët jo materiale			
Totali i aktiveve afatgjatë		2,428,167	-
TOTALI I AKTIVEVE		10,100,970	-
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë			
Furnitorë dhe detyrime të tjera	7	3,606,755	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	8	2,913,341	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		6,520,096	-
Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë			
Totali i detyrimeve afatgjatë			
Total i detyrimeve		6,520,096	-
Kapitali i nënshkruar			
Fitime/(humbje) e mbartur	9	100,000	-
Rezultati periudhës	9	3,480,874	-
Kapitalet e veta		3,580,874	-
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		10,100,970	-

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese nga faqja 1 deri 13 janë firmosur dhe miratuar me 31 Mars 2017 nga:

ADMINISTRATOR
Eriola Likaj

Shef Finance
Holta Vrenezi

PASQYRA E PERFORMANCES

(Gjithë vlerat në Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	10	9,142,850	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	11	(1,106,400)	-
Marzhi bruto		8,036,450	-
Shpenzime të personelit	12	(3,477,689)	-
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative			
Shpenzime të tjera	13	(309,927)	-
Shpenzime zhvërsimi dhe amortizimi	6	(113,267)	-
Totali i shpenzimeve operative		(3,900,883)	-
Fitimi nga aktiviteti kryesor		4,135,567	-
Të ardhura të tjera	14	3,414	-
Shpenzime Financiare			
Fitime/(humbje) financiare		3,414	-
Fitime/(humbje) përpara tatimit		4,138,981	-
Tatim fitimi	15	(658,107)	-
Fitime/(humbje) për periudhën		3,480,874	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse	15	3,480,874	-

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

(Gjithë vlerat në Lekë)

	Shënime	Viti i mbyllur 31 Dhjetor	
		2016	2015
Fitime/(humbje) për periudhën	15	3,480,874	-
<i>Korrigjime për:</i>			
Shpenzime Zhvlerësimi dhe Amortizimi	6	113,267	-
Të ardhura nga kursi këmbimit			
Të ardhura nga interesi			
Shpenzime për interesa			
Fitimi nga aktiviteti përpara ndryshimeve në kapitalin punues		3,594,141	-
(Rritje)/ulje në inventar		(230,440)	-
(Rritje)/ulje në klientë dhe të tjera kërkesa për arkëtim		(7,392,670)	-
Rritje/(ulje) në furnitorë dhe detyrimet e tjera		3,606,755	-
Fluksi i parasë nga aktiviteti kryesor		(422,214)	-
Interes i arkëtuar			
Fluksi neto i parasë nga aktiviteti kryesor		(422,214)	-
Fluksi i mjeteve monetare nga/ përdorur në aktivitetin e investimit			
Blerje aktive afatgjata materiale	6	(2,541,434)	-
Mjete monetare neto të përdorura në aktivitetin e investimit		(2,541,434)	-
Fluksi i mjeteve monetare nga/ përdorur në aktivitetin e financimit			
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksioner		100,000	-
Hua të arkëtuara nga Institucionet Financiare			
Hua të arkëtuara nga Palët e Lidhura		7,150,226	-
Pagesa e huave		(4,236,885)	-
Interes i paguar			
Fluksi neto nga financimet		3,013,341	-
Rritja/(pakësimi) neto në mjete monetare	3	49,693	-
Mjete monetare në 1 Janar		-	-
Mjete monetare në 31 Dhjetor		49,693	-




Clean Fast sh.p.k

PASQYRA E LEVIZJEVE NE KAPITAL

(Gjithë vlerat në Lekë)

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Fitim/Humja e Mbartur	Totali
Gjendje në 31 Dhjetor 2014	-	-	-	-
Tërheqje				-
Fitimi i vitit 2015	-	-	-	-
Gjendje në 31 Dhjetor 2015	-	-	-	-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	3,480,874	3,480,874
Dividendët e paguar	-	-	-	-
Rritje e kapitalit	100,000	-	-	100,000
Rritja e rezervave të tjera	-	-	-	-
Gjendje në 31 Dhjetor 2016	100,000		3,480,874	3,580,874



Clean Fast sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqëria "Clean Fast" sh.p.k është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në dt.06.06.2016. Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 lekë dhe ortak i shoqërisë me pjesëmarrje 100% është Zj.Eriola Likaj, e cila është dhe Administratore e shoqërisë. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në ambientet e marra me qira.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008, nga statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë përfshin sa më poshtë:

Shoqëria "Clean Fast" sh.p.k ka si objekt :- Aktivitet në fushën e lavanteri dhe pastrime, pastrime të ambjentëve të përbashketa , pastrime kimike për entet publike dhe private vendase dhe të huaja, banka, qendra tregtare, spitale , shkolla , konvikte , hotele, restorante, kinema, etj. Veprimtari në fushën e pastrimit, desinfektimit, deratizimit, të ambjentëve të brendshme dhe të jashtme në entet publike dhe private . Pastrime, larje, sterilizime, disinfektime, hekurosje, paketime , dhe administrime të këtyre veprimtarive për persona fizik e juridik, ente publike etj. Aktivitete të lidhura me shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimeve. Shitje me shumicë e pakicë e mallrave të ndryshme, të pastrimit, ushqimore , industrial, të ndërtimit , mjeteve e pajisje teknologjike, sistemeve dhe pajisjeve elektroteknike e elektronike. Administrimi i qendrave të rehabilitimit, shtëpive të të moshuarve, qendrave social kulturore e sportive.

Më 31 Dhjetor 2016 shoqëria kishte 51 të punësuar. Adresa e subjektit: "Tiranë Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga Fortuzi, Apartamenti në katin e parë, Pasuria me Nr. 5/209+1-2, ZK. 8350"

Pasqyrat financiare të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 janë miratuar nga Administratori i shoqërisë Zj. Eriola Likaj më 31 Mars 2017.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE

a. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare


Paqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKK) hyrë në fuqi nga 1 Janar 2015, të cilat përbëhen nga rregullat dhe interpretimet në përputhje me Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Çdo veprim është mbështetur në dokumente justifikuese. Veprimet janë ngurtësuar më 31 dhjetor 2016.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë prezantuar në Lekë Shqiptare (LEKE), që është monedha raportuese e shoqërisë. Veprimet janë hedhur në mënyrë kronologjike dhe të kompjuterizuar në programin "FINANCA 5". Veprimet janë ngurtësuar më 31.12.2016.

b. Rëndësia dhe materialiteti

Pasqyrat financiare paraqesin të gjithë informacionin material që ndikon në pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të njësisë ekonomike. Informacioni në këto pasqyra konsiderohet material, nëse mungesa ose pasaktësia në paraqitjen e tij do të ndikonte në vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare. Zërat jomateriale mund të njihen duke përdorur metoda më të thjeshtuara.

Në mbështetje të SKK-ve të përmirësuara (SKK1 paragrafi 71) në përgatitjen e pasqyrave financiare rëndësi u jepet atyre aspekteve dhe të dhënave financiare të aktiviteteve ekonomike që



**Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**

janë të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave financiare dhe që mund të ndikojnë në vendimet ekonomike që ata marrin. Rëndimi i pasqyrave financiare me hollësira të tepruara dhe informacion jomaterial dëmton qartësinë dhe kuptueshmërinë e tyre.

Në përcaktimin e materialitetit janë marrë parasysh aspektet cilësore dhe sasore të informacionit. Për kontabilizimin dhe raportimin e zërave jomaterialë në pasqyrat financiare kompania ka adoptuar plotësisht kërkesat e SKK-ve të përmirësuara edhe në përputhje me kërkesat SKK1 paragrafi 74 . Informacioni, në lidhje me zërat dhe transaksionet materiale, do të shpjegohet më vete në shënime të pasqyrave financiare. Zërat jomaterialë raportohen në pasqyrat financiare të grupuara me zëra të tjerë jomaterialë të ngjashëm.

c. Aktivet materiale dhe jomateriale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

b. Aktivet materiale dhe jomateriale


(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Toka nuk amortizohet.

Normat e përdorura janë sipas ligjit 8438 dt.28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" për të gjitha aktivet që disponon shoqëria me përqindjet respektive të vlerës së mbetur.

**2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RENDESISHME KONTABILE
(VAZHDIM)**

Aktivët afatgjatë jomateriale njihen atëherë kur është e mundur që përfitime ekonomike do të sigurohen në të ardhmen në lidhje me këto aktive dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme.


6

Clean Fast sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

c. Inventarët

Vlerësimi në hyrje i inventarëve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventarët në kushte magazinimi. Gjatë shitjes së mallrave shkarkimi bëhet me kosto mesatare. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

d. Llogaritë e arkëtueshme dhe llogari të pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe me pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

e. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat në Lekë dhe në monedha të huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.


f. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me AAM për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lekë):

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
1 EUR	135,23	137,28
1 USD	128,17	125,79
1 GBP	157,56	186,59



**2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE
(VAZHDIM)**

f. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara, mbështetur në dokumentacionin justifikues. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftushme në marrjen e përfitimeve. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve, dhe në të njëjtin ushtrim kontabël me të ardhurat e lidhura, duke u mbështetur në dokumentacionin justifikues.

g. Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshëm për vitin aktual, bazohet mbi fitimin e tatueshëm, i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2016 është 15 %.

f. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet për pensione si edhe kontribute për sigurim shëndetësor për punonjësit e saj siç është parashikuar nga legjislacioni social vendas. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtarë përgjegjës për pagesën e pensioneve dhe shpenzimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe shpenzime shëndetësore.

g. Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

f. Korigjimi i gabimeve

Në përputhje me kërkesat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit kompania ka adoptuar plotësisht kërkesat e këtyre standardeve për vlerësimet kontabël dhe ndryshimet e tyre dhe korrigjimet e gabimeve.

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit specifikojnë se gabimet janë mosraportime ose deklarime të gabuara në pasqyrat financiare të një ose më shumë periudhave kontabël, të cilat vijnë nga mospërdorimi ose keqpërdorimi i informacionit të disponueshëm nga drejtuesit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Gabime të tilla përfshijnë efektet e gabimeve matematikore, gabimeve në zbatimin e politikave kontabël, paqartësitë apo keqinterpretimet e fakteve.

Gabimet ndryshojnë nga ndryshimet në vlerësimet kontabël. Ndryshimet në vlerësimet kontabël bazohen në informacion të mjaftueshëm dhe të besueshëm, si dhe në ndryshimin e tij me kalimin e kohës, dhe nuk kanë të bëjë me përdorimin e gabuar të tij. Gabimi karakterizohet nga fakti që, ndonëse drejtuesit e njësisë ekonomike kishin informacion të mjaftueshëm e të besueshëm për të përgatitur pasqyra financiare të sakta në kohën e përgatitjes së tyre, ky informacion nuk u përdor me saktësi.



8

Clean Fast sh.p.k


Shënime të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

g. Biznesi në vijimësi

Të dhënat e kontabilitetit janë mbajtur duke qënë në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, në mënyrë të veçantë me bazën e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhës, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit në vijimësi.

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecurisë normale të biznesit.



Clean Fast sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016****3. MJETE MONETARE**

Mjetet monetare për vitin që u mbyll me 31 Dhjetor 2016 janë të ndara sipas gjëndjes së tyre në arkë dhe në bankë. Shoqëria operon me 2 Banka, përkatësisht Bankën Kombëtare Tregëtare dhe Raiffeisen Bank. Tepëricat e paraqitura më poshtë janë përkthyer me kursin e fundit të vitit të publikuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.


	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Arka	8,743	-
Banka	40,950	-
	49,963	-

4. TË DREJTA TË ARKËTUESHME

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Klient dhe kërkesa të tjera të arkëtueshme	7,392,670	-
Paradhënie dhe parapagime	-	-
Debitorë të tjerë	-	-
Të drejta lidhur me kapitalin aksionar të pa paguar	-	-
Të drejta të tjera - TVSH	-	-
Të drejta për tatim fitimin	-	-
Të drejta ndaj palëve të lidhura	-	-
	7,392.670	-

5. INVENTARET

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Materiale të para	230,440	-
Të tjera	-	-
	230,440	-



Clean Fast sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

6. AKTIVET MATERIALE DHE JO MATERIALE

	Ndërtesa	Makinieri e pajisje dhe mjete transporti	Pajisje Zyre & Informatike	Totali
<i>Aktive të Trupëzuara</i>				
Gjendje 01.01.2016	-	-	-	-
Shtesa	-	2,541,434	-	2,541,434
Pakësime	-	-	-	-
Gjendje 31.12.2016	-	2,541,434	-	2,541,434
<i>Amortizimi</i>				
Gjendje në 01.01.2016	-	-	-	-
Shtesa llogaritur	-	113,267	-	113,267
Pakësime	-	-	-	-
Gjendje në 31.12.2016	-	113,267	-	113,267
Vlera neto 01.01.2016	-	-	-	-
Vlera neto 31.12.2016	-	2,428,167	-	2,428,167

Clean Fast sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016****7. FURNITORE DHE DETYRIME TE TJERA**

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Furnitorë	660,000	-
Të pagueshme ndaj punonjësve & sig. shoq./ shënd.	1,240,088	-
Detyrime për tatimin në burim	4,020	-
TVSH	1,074,540	-
Tatim fitimi	628,107	-
	3,606,755	-

8. DETYRIME NDAJ PALEVE TE LIDHURA

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	2,913,341	-
	2,913,341	-

9. KAPITALET E VETA

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Kapitali	100,000	-
Rezerva Ligjore	-	-
Rezerva të tjera	-	-
Fitime të pa shpërndara	-	-
Fitim/humbja e vitit	3,480,874	-
Totali	3,580,874	-

10. TE ARDHURAT NGA SHITJA E MALLRAVE

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë 9,142,850 Lekë.

11. LENDA E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Mallra e materiale të tjera	1,105,886	-
Mallra etj(të panjohura)	514	-
Totali	1,106,400	-

12. SHPENZIME PER PERSONELIN

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Pagat dhe shpërblimet e personelit	2,720,681	-
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	509,122	-
Shpenzime të panjohur për personelin	247,886	-
	3,477,689	-

Clean Fast sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

13. SHPENZIME TE TJERA

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Lëndë djegëse	99,999	
Shërbime të tjera	28,412	-
Qira	166,600	-
Shpenzime bankare	14,916	-
	309,927	-

14. SHPENZIME FINANCIARE


	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Fitim nga këmbime valutore	6,506	-
Të ardhura nga interesat	5	-
Shpenzime nga këmbimet valutore	(3,096)	-
	3,414	-

15. FITIMI NETO

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Fitimi bruto	4,138,981	-
Shpenzime të panjohura	248,400	-
Baza e llogaritjes së tatimit	4,387,381	-
% e tatim fitimit	15%	
Tatim fitimi	658,107	
Fitimi neto	3,480,874	-

16. NGJARJE TE TJERA PAS DATES BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje të rëndësishme pas mbylljes së vitit ushtrimor që të kërkojë korrigjime apo përshkrime në këto pasqyra financiare përveç atyre të paraqitura në shënimet e këtyre pasqyrave financiare.


13